



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 27

2000

Gusht

P Ë R M B A J T J A

Vendim i KM nr.342, datë 7.7.2000	Për lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë të nëpunësit civil.....	1377
Vendim i KM nr.348, datë 7.7.2000	Për njësitë e shoqërisë "Servcom", sh.a, që nuk do të konsiderohen pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë.....	1378
Vendim i KM nr.393, datë 20.7.2000	Për disa ndryshime në vendimin nr.60, datë 27.2.1992, të Këshillit të Ministrave, në vendimin nr.54, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave dhe në vendimin nr.56, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave.....	1379
Vendim i KM nr.394, datë 27.7.2000	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shëndetësor Rajonal të Tiranës.....	1380

Vendim i KM nr.396, datë 27.7.2000	Për njohjen e periudhës së sigurimit për efekt pensioni dhe aksidenti në punë të të dënuarve me burgim.....	1385
Vendim i KM nr.398, datë 27.7.2000	Për përjashtim të shoqërive huamarrëse nga pagesat e prapambetura të qirasë së tokës.....	1386
Vendim i KM nr.400, datë 27.7.2000	Për miratimin e privatizimit të ndërmarrjes së prodhimit të çimentos, Fushë-Krujë.....	1387
Vendim i KM nr.405, datë 27.7.2000	Për kushtet e nxjerrjes së pullës postare shqiptare.....	1388
Vendim i KM nr.407, datë 27.7.2000	Për miratimin e strategjisë së ristrukturimit të Bankës së Kursimeve, sh.a.....	1390
Vendim i KM nr.409, datë 27.7.2000	Për një ndryshim në vendimin nr.157, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për fillimin e punës së zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme në disa rrethe".....	1390
Vendim i Gj.L nr.932	Me objekt: Deklarimi i pavlefshëm i kontratës së huasë me Nr.Rep.1757 Kol.599, datë 14.10.1996, në bazë të neneve 92 e 686 të Kodit Civil dhe nenit 153 të Kodit të Procedurës Civile.....	1396

V E N D I M
Nr.342, datë 7.7.2000

PËR LËVIZJEN PARALELE DHE NGRITJEN NË DETYRË TË NËPUNËSIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13,14,15 dhe 29, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Për statusin e nëpunësit civil", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Procedurat e planifikimit për plotësimin e vendeve të lira, të parashikuara nga pika 1 deri në 5, të vendimit nr.231, datë 11.5.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën e provës", shërben edhe për lëvizjen paralele dhe për ngritjen në detyrë.

2. Shpallja e konkurimit për lëvizjen paralele përmban këto të dhëna:

a) Një përshkrim të shkurtër të vendit të punës: pozicioni, sektori, drejtoria dhe institucioni;

b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët, në përputhje me përshkrimin e punës për vendin e lirë;

c) Pozicionet në shërbimin civil, që përfitojnë nga procedura e lëvizjes paralele;

ç) Një listë të dokumenteve që duhet të paraqiten dhe vendin ku do të paraqiten;

d) Afatin deri kur do të paraqiten dokumentet, i cili duhet të jetë më i vogël se 30 ditë nga data e botimit të shpalljes për konkurim.

dh) Mënyrën dhe kohën kur do të shpallet lista e kandidatëve, që do t'i paraqiten eprorit të drejtpërdrejtë, sipas pikës 5 të këtij vendimi.

3. Departamenti i Administratës Publike, me shpenzimet e institucionit që ka vendin e lirë, boton shpalljen e vendit të lirë në dy gazeta kombëtare, me qarkullim më të madh. Në institucionet e pavarura betimi bëhet nga departamenti, drejtoria, seksioni apo zyra e personelit.

4. Departamenti i Administratës Publike bën verifikimin e kandidatëve, të cilët, sipas fotokopjeve të dokumenteve të paraqitura përmbushin kërkesat e veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim. Në institucionet e pavarura verifikimi bëhet nga departamenti, drejtoria apo zyra e personelit.

5. Kandidatët, që plotësojnë kërkesat e veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim, renditjen, nga Departamenti i Administratës Publike, në listën e kandidatëve sipas rendit alfabetik dhe i paraqiten eprorit të drejtpërdrejtë. Personat që nuk plotësojnë kërkesat e veçanta renditen në një listë tjetër, ku tregohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Listat e mësipërme shpallen në kohën dhe në mënyrat e përcaktuara në shpalljen për konkurim.

6. Brenda 3 ditëve nga shpallja e listave, personat e interesuar mund t'i parqesin ankesat në Departamentin e Administratës Publike, për institucionet e administratës qendrore, ose në departamentin, drejtorinë, seksionin apo zyrën e personelit, për institucionet e pavarura. Ankesat zgjidhen brenda 3 ditëve nga marrja e tyre. Paraqitja e ankesave të mësipërme nuk prek të drejtën e ankimit në komisionin e shërbimit civil.

7. Dy ditë pas zgjidhjes së ankesave apo kalimit të afatit për zgjidhjen e tyre, Departamenti i Administratës Publike, për institucionet e administratës qendrore, apo departamenti, drejtoria, seksioni apo zyra e personelit, për institucionet e pavarura, ia dërgojnë listën e kandidatëve, që plotësojnë kërkesat e veçanta, eprorit të drejtpërdrejtë, përkatës. Kandidatët nuk i nënshtrohen testimit para komiteteve ad hoc.

8. Eprori i drejtpërdrejtë, sipas klasës së nëpunësit civil, përpara se të zgjedhë njërin nga kandidatët e paraqitur, zhvillon, si rregull, një bashkëbisedim me secilin prej tyre.

9. Vendimi i eprorit të drejtpërdrejtë duhet të jetë i motivuar dhe të bazohet në parimet e barazisë, të mirëbesimit dhe të mosdiskriminimit.

10. Nëse në përfundim të procedurave të pikës 7 të këtij vendimi Departamenti i

Administratës Publike, për institucionet e administratës qendrore, apo departamenti, drejtoria, seksioni apo zyra e personelit, për institucionet e pavarura, vëren se asnjëri nga kandidatët nuk përmbush kërkesat e veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim, fillon procedurën e ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë, ekzistues.

11. Shpallja e konkurimit për ngritjen në detyrë përmban të dhënat sipas pikës 2 të këtij vendimi, përveç shkronjës “c”, ku përcaktohen pozicionet e shërbimit civil, që përfitojnë nga ngritja në detyrë.

12. Procedura e ngritjes në detyrë është e njëjtë me atë të pranimit në shërbimin civil, sipas vendimit nr.231, datë 11.5.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën e provës”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.348, datë 7.7.2000

**PËR NJËSITË E SHOQËRISË “SERVCOM”, SH.A., QË NUK DO TË KONSIDEROHEN
PJESË TË SEKTORËVE ME RËNDËSI TË VEÇANTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998, “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë“, ndryshuar me ligjin nr.8582, datë 23.2.2000, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në shoqërinë “Servcom” sh.a., Fier, njësitë e zbatimit të investimeve në Patos dhe të Sizmikës, Fier, nuk do të konsiderohen pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.393, datë 20.7.2000

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.60, DATË 27.2.1992, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, NË VENDIMIN NR.54, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
DHE NË VENDIMIN NR.56, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e zëvendëskryeministrit e ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.60, datë 27.2.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë

dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve”, bëhen këto ndryshime:

- a. Në pikën 1, niveli më i ulët i pagës 7 018 lekë në muaj, kurse paga më e lartë (drejtor drejtorie) bëhet 29 700 lekë në muaj.
- b. Në pikën 2, paga e ushtarakëve, nxënësve dhe studentëve ushtarakë bëhet 847 lekë në muaj.
- c. Në pikën 5, paragrafi 3, paga për ushtarin rezervist bëhet deri 605 lekë në ditë.
- ç. Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

Shef i Shtabit të Përgjithshëm	70 785 lekë
Zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm	55 539 lekë
Drejtor i Përgjithshëm	57 596 lekë
Shef i kabinetit të ministrit	54 208 lekë
Këshilltar i ministrit	45 617 lekë

2. Në vendimin nr.54, datë 27.2.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për sistemin e pagave të Ministrisë së Rendit Publik dhe ushtarakëve të Ministrisë së Drejtësisë“, bëhen këto ndryshime:

- a. Në pikën 1, niveli më i ulët i pagës bëhet 7 018 lekë në muaj dhe niveli më i lartë bëhet 30 558 lekë në muaj.
- b. Në pikën 3, paga e ushtarakëve të shërbimit të detyrueshëm dhe studentëve të shkollave të Ministrisë së Rendit Publik bëhet deri në 847 lekë në muaj.
- c. Për ushtarakët e sistemit të Ministrisë së Rendit Publik, paga e të cilëve është përcaktuar me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave (jashtë sistemit të pagave me klasa), rriten 10 për qind.

ç. Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

Drejtor i Përgjithshëm i Policisë	67 155 lekë
Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Policisë	60 808 lekë
Komandant i Gardës së Republikës	60 808 lekë
Drejtor i Policisë së Burgjeve	52 635 lekë

3. Në vendimin nr.56, datë 27.2.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve në Shërbimin Informativ Kombëtar”, bëhen këto ndryshime:

- a. Në pikën 1, niveli më i ulët i pagës bëhet 7 018 lekë në muaj dhe niveli më i lartë (drejtor drejtorie) bëhet 29 700 lekë në muaj.
- b. Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

Drejtor i Shërbimit Informativ Kombëtar	90 750 lekë
Zëvendësdrejtor i Shërbimit Informativ Kombëtar	61 710 lekë
Inspektor i Përgjithshëm Informativ Kombëtar	61 710 lekë

4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen, në përputhje me pikën 1, të aktit normativ nr.1, datë 14.7.2000, “Për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga rritja e pagave dhe pensioneve”.

5. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 1.7.2000.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 394, datë 27.7.2000

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT
SHËNDETËSOR RAJONAL TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr.3766, datë 17.12.1963, “Për kujdesin shëndetësor”, të ligjit nr.8380, datë 29.7.1998, “Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA) për projektin e rimëkëmbjes së sistemit shëndetësor”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Autoritetit Shëndetësor Rajonal (ASHR) të Tiranës. ASHR-ja është një organ publik, me autonomi të kufizuar, për menaxhimin, dhënien dhe sigurimin e kujdesit shëndetësor, parësor, si dhe për kryerjen e shërbimeve shëndetësore, të specializuara, të shërbimit parësor. ASHR-ja mbulon dhe përfshin bashkinë dhe rrethin e Tiranës, por nuk përfshin e as menaxhon Qendrën Spitalore Universitare, Spitalin Obstetrik dhe Gjinekologjik dhe Institutin Pneuftiziatrik (Sanatoriumin).

2. ASHR-ja krijohet si një projekt pilot, i cili do të vlerësohet brenda vitit të dytë të qënies së tij, me qëllim që, kur është mundësia, e njëjta strukturë, me organizim shëndetësor si ASHR-ja të shtrihet në gjithë territorin e vendit.

3. ASHR-ja funksionon sipas rregullores e cila i bashkëlidhet vendimit.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

**RREGULLORE PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT
SHËNDETËSOR RAJONAL TË TIRANËS**

I. Autonomia dhe qëllimet

1. Krijimi dhe funksionimi i Autoritetit Shëndetësor Rajonal (ASHR) synon në ngritjen dhe përmirësimin e cilësisë së kujdesit dhe shërbimit shëndetësor në zonën e shtrirjes së aktivitetit të tij.

Autoriteti Shëndetësor Rajonal (ASHR) është organ publik, me autonomi të kufizuar, për menaxhimin, dhënien e sigurimin e kujdesit shëndetësor parësor, si dhe për kryerjen e shërbimeve shëndetësore të specializuara spitalore ose ambulatorë të tjera.

ASHR-ja mbulon dhe përfshin Bashkinë dhe Rrethin e Tiranës.

ASHR-ja nuk përfshin e as menaxhon Qendrën Spitalore Universitare, Spitalin Obsetrik dhe Gjinekologjik dhe Institutin Pneuftiziatrik (Sanatoriumin).

II. Burimet financiare dhe menaxhimi i tyre.

1. ASHR-ja financohet nga buxheti i shtetit nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë (MSH).

2. ASHR-ja mund të financohet drejtpërdrejt edhe nga donacione e burime të tjera të ligjshme.

3. ASHR-ja mund të sigurojë të ardhura nga marrëveshjet që nënshkruan me MSH ose me organe e organizata të tjera të vendit ose të huaja, për kryerjen e shërbimeve të caktuara brenda objektit të përcaktuar në nenin 1.

4. ASHR-ja menaxhon dhe të rishikon buxhetin e vet,
5. ASHR-ja nuk mund të shesë pasuritë e saj pa miratimin e MSH.
6. ASHR-ja ka të drejtë të përcaktojë nivelin e vet të pagave në përputhje me politikën e përgjithshme të MSH, si dhe kushtet dhe afatet për kryerjen e shërbimeve.
7. ASHR-së i ndalohet të marrë hua nga sektori privat.

III. Organet Drejtuese

Organet drejtuese të ASHR-së janë: Bordi dhe Drejtori Ekzekutiv.

1. Bordi përbëhet nga:
 - a) Dy anëtarë të emëruar nga Ministri i Shëndetësisë, por në asnjë rast vetë Ministri;
 - b) Një përfaqësues i Ministrisë së Financave.
 - a) Kryetari i Bashkisë së Qytetit ose një përfaqësues nga Bashkia;
 - b) Kryetari i Këshillit të Rrethit ose një përfaqësues nga Këshilli i Rrethit;
 - c) Një përfaqësues i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (“ISKSH”);
 - d) Një përfaqësues nga Qarku; dhe
 - e) Drejtori Ekzekutiv i ASHR-së së Tiranës.
2. Anëtarët e Bordit qëndrojnë në detyrë për 4 vjet, me të drejtë riemërimi, me përjashtim të rregullit të parashikuar në pikën IV/3.
3. Për së siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë së Bordit, nuk mund të zëvendësohen në të njëjtën kohë më shumë se katër anëtarë të tij, të cilët caktohen me short. Anëtarët e tjerë vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë edhe për një vit. Për efekt të zbatimit të këtij paragrafi, me fjalët “në të njëjtën kohë” do të kuptohet një periudhë kohore deri në tre muaj, brenda së cilës duhet të bëhet zëvendësimi i jo më pak se 4 anëtarëve.
 4. Një anëtar i Bordit mund të largohet nga detyra para afatit kur:
 - a. Anëtari nuk merr pjesë në 4 mbledhje të Bordit brenda një viti.
 - b. Anëtari kryen veprime ose mosveprime që vijnë në kundërshtim me ligjet, me aktet e ASHR-së, si dhe me rregulloren e Bordit.
 5. Kur janë rastet e parashikuara në paragrafin 4 të këtij neni, me kërkesë të Bordit ose edhe me iniciativën e tij entiteti përfaqësues respektiv, e largon anëtarin nga detyra dhe në vend të tij emëron një tjetër.

IV. Kryetari i Bordit

1. Bordi zgjedh kryetar të Bordit një nga përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë.
 - a. Kryetari i Bordit zgjidhet njëherë në 3 vjet me të drejtë zgjedhjeje.
 - b. Bordi zgjedh nënkryetarin e tij për 3 vjet me të drejtë rizgjedhjeje.
 - c. Përfaqësuesi i ISKSH-së nuk mund të jetë zëvendëskryetar Bordi.
2. Kryetari i Bordit kryen këto funksione:
 - a. Përfaqëson Bordin në marrëdhëniet me të tretët;
 - b. Drejton mbledhjet e Bordit dhe është përgjegjës për aktivitetin e tij;
 - c. Mundëson dhe ndikon që anëtarët e Bordit të marrin pjesë dhe të japin kontributin e tyre të plotë për përmbushjen e detyrave të Bordit dhe të aktiviteteve të tij.

V. Rregulla të funksionimit të Bordit

1. Bordi mbledhet jo më pak se gjashtë herë në vit.
2. Bordi mbledhet kur e thërret Kryetari i tij ose jo më pak se një e dyta e të gjithë anëtarëve të Bordit.
3. Mbledhjet e Bordit janë të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
4. Bordi i merr vendimet me shumicë votash.

VI. Funkcionet e Bordit

Bordi ushtron kryesisht këto funksione:

1. Të miratojë politikën, strategjinë, planet (afatshkurtra dhe afatgjata), programet dhe prioritetet shëndetësore në përputhje me politikat kombëtare shëndetësore të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë (në këtë paragraf u përfshinë edhe paragrafet 2 dhe 3).
2. Të aprovojë ndryshimet strukturore.
3. Të paraqesë e propozojë përpara Ministrisë së Shëndetësisë projektakte normative.
4. Të miratojë buxhetin, ndarjen e destinacionin e fondeve financiare.
5. Të miratojë planet e programet për zhvillimin, trainimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore në përputhje me politikat e përgjithshme të Ministrisë së Shëndetësisë.
6. Të miratojë emërimin e drejtorëve të Drejtorive të ASHR-së. Marrja dhe largimi nga puna i drejtorëve të drejtorive si dhe punonjësve të tjerë të ASHR-së bëhet në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.
7. Të përcaktojë kushtet dhe nivelet pagave të punonjësve të ASHR-së në marrëveshje me MSh dhe ISKSH.
8. Të përcaktojë numrin e punonjësve të ASHR-së si dhe kriteret e punësimit të tyre.
9. Të vendos për krijimin e fushave të reja të shërbimeve brenda politikave shëndetësore kombëtare të përcaktuara nga MSH.

VII. Drejtori Ekzekutiv – emërimi dhe afati

1. Drejtori Ekzekutiv zgjidhet nga Bordi i ASHR-së. Drejtori Ekzekutiv e merr detyrën vetëm pasi të miratohet nga Ministri i Shëndetësisë.
2. Drejtori Ekzekutiv raporton dhe përgjigjet përpara Bordit.
3. Drejtori Ekzekutiv qëndron në detyrë për 3 vjet me të drejtë rizgjedhjeje.
4. Drejtori Ekzekutiv mund të shkarkohet nga detyra para afatit nga Bordi, për të cilin duhet të kenë votuar më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të bordit, kur Drejtori kryen veprime ose mosveprime që vijnë në kundërshtim me ligjet, aktet e ASHR-së, si dhe me rregulloren e ASHR-së.

VIII. Funkcionet e Drejtorit Ekzekutiv

Drejtori Ekzekutiv ushtron kryesisht këto funksione:

1. Të hartojë politikën, strategjinë, planet, programet e prioritetet shëndetësore në bazë të politikës kombëtare të përpunuar nga Ministria e Shëndetësisë.
2. Të koordinojë aktivitetet shëndetësore, duke përfshirë atë të sektorit privat dhe të organizatave jo-qeveritare.
3. Menaxhon e drejton shërbimet shëndetësore.
4. Të përgatisë e hartojë buxhetin, ndarjen e destinacionin e fondeve buxhetore të financuara, si dhe mënyrat dhe format e evidentimit dhe të kontrollit të administrimit të këtyre fondeve sipas ligjeve (ligji organik dhe ligji vjetor) për buxhetin e shtetit dhe udhëzimeve të ndryshme në zbatim të tyre.
5. Të hartojë e përgatisë planet e programet për zhvillimin, kualifikimin dhe administrimin e burimeve njerëzore në përputhje me politikat e Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe të vejë në jetë e zbatojë ato.
6. Të drejtojë e kontrollojë të gjitha aktivitetet zbatuese e administruese të organeve dhe organizmave të ASHR-së.
7. Përfaqëson ASHR-në në marrëdhëniet e punës me punonjësit.
8. Emëron drejtorët e Drejtorive të ASHR-së.
9. Propozon futjen e shërbimeve të reja, sipas politikave shëndetësore kombëtare të përcaktuara nga MSH.
10. Mbështetet me mjete teknike dhe mbikëqyr veprimtarinë e punonjësve të niveleve të

ndryshme si dhe ato që përfshihen në programe të ndryshme të shëndetësisë.

IX. Organizmat e brendshëm

1. Drejtoria e Shëndetit Publik
2. Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor Parësor;
3. Drejtoria e Planifikimit të Shërbimeve;
4. Drejtoria e Shërbimeve Kontraktuese dhe Ndihmëse

X. Drejtoritë e ASHR-së dhe fushat kryesore që mbulojnë

1. Drejtoria e Shëndetit Publik mbulon kryesisht këto fusha:
 - a) Promovimin dhe edukimin shëndetësor;
 - b) Imunizimi dhe Sëmundjet infektive;
 - c) Ushqimi, uji, trajtimi i mbeturinave;
 - d) Shëndeti dhe sigurimi në punë;
 - e) Shërbimet laboratorike të shëndetit publik;
 - f) Inspektimi farmaceutik;
 - g) Inspektoriatin Sanitar Shtetëror;
 - h) Inspektoriatin e luftës kundër sëmundjeve ngjitëse.
2. Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor Parësor mbulon kryesisht këto fusha:
 - a) Shërbimet klinike, si dhe poliklinikat dhe qendrat shëndetësore;
 - b) Shërbimi stomatologjik;
 - c) Drejtimi dhe menaxhimi mjekësor;
 - d) Profesionet që lidhen me mjekësinë, si punonjësit e radiografisë, të laboratorëve etj.
 - e) Kontrolli mjekësor;
 - f) Shërbimet infermerike;
 - g) Drejtimi dhe menaxhimi infermierik;
 - h) Sigurimi i cilësisë së shërbimit infermierik;
3. Drejtoria e Planifikimit të Shërbimeve mbulon kryesisht këto fusha:
 - a) Planifikimin dhe zhvillimin e Shërbimeve Shëndetësore të Specializuara Spitalore ose Ambulatore;
 - b) Informacioni dhe statistikat;
 - c) Kontrollin financiar; shpenzimet dhe buxheti; shërbimet në lidhje me pagesat (funksionet e arkëtarit) dhe menaxhimi i parave.
 - d) Burimet njerëzore;
 - e) Menaxhimi i pronave dhe pasurive;
 - f) Shërbimet juridike;
 - g) Furnizimet;
 - h) Administrata.

XI. Drejtorët e drejtorive

1. Drejtorët janë përgjegjës për funksionimin e Drejtorive dhe menaxhimin e veprimtarive përkatëse, për administrimin e ndërtesave dhe të pajisjeve të tyre, për cilësinë e shërbimeve.
2. Drejtorët përfaqësojnë Drejtoritë përkatëse në marrëdhënie me të tretët.
3. Drejtorët varen drejtpërdrejt dhe përgjigjen përpara Drejtorit Ekzekutiv.
4. Rregullat e Kodit të Punës, për aq sa nuk vijnë në kundërshtim me këtë vendim, si dhe me statusin e veçantë të ASHR-së, do të zbatohen edhe për Drejtorët e Drejtorive, si dhe për punonjësit e tjerë të ASHR-së.

XII. Poliklinikat dhe Qendrat Shëndetësore

1. Poliklinikat dhe Qendrat Shëndetësore janë pjesë e Drejtorisë së Kujdesit Shëndetësor Parësor.
2. Shefat e poliklinikave dhe të qendrave shëndetësore varen dhe përgjigjen përpara Drejtorit të Drejtorisë së Kujdesit Shëndetësor Parësor.
3. Shefat e poliklinikave dhe të qendrave shëndetësore janë përgjegjës për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve.
4. Shefat e poliklinikave dhe të qendrave shëndetësore janë përgjegjës për ushtrimin e kontrollit ndaj veprimtarisë së shpenzimeve për menaxhimin e mirëmbajtjen e ndërtesave dhe të pajisjeve të tyre, si dhe për kryerjen e realizimin e shërbimeve dhe të aktiviteteve të tjera.

XIII. Stafet e poliklinikave dhe të qendrave shëndetësore

1. Specialistët doktorë, infermierët dhe pjesa tjetër e stafit, si dhe mjekët e përgjithshëm, të poliklinikave dhe qendrave shëndetësore punësohen me kontratë nga Drejtori i Drejtorisë së Kujdesit Shëndetësor Parësor, mbi bazën e kritereve të vendosura me rregulloren e brendshme.
2. Punonjësit e poliklinikave dhe të qendrave shëndetësore do të paguhen nga fondi i Sigurimeve Shëndetësore, në bazë të Marrëveshjes që do të lidhen ndërmjet ARSH-së dhe ISKSH-së.

XIV. Financimi i poliklinikave dhe qendrave shëndetësore

1. Shpenzimet për kryerjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor do të financohen nga ISKSH-ja, sipas Marrëveshjes së lidhur ndërmjet ASHR-së dhe ISKSH-së.
2. Marrëveshja përcakton paketat e shërbimeve shëndetësore që do të blejë ISKSH-së për çdo poliklinikë dhe qendër shëndetësore. Në paketat e shërbimit shëndetësor përfshihen shpenzimet për pagesat e mjekëve të përgjithshëm e të familjeve, mjekëve specialistë, infermierëve, të punësuarve të tjerë në poliklinika dhe qendra shëndetësore, si dhe shpenzime të tjera (korrente).
3. Në përputhje me Marrëveshjen ndërmjet ASHR-së dhe ISKSH-së, dega e ISKSH-së lidh kontratë me çdo poliklinikë dhe qendër shëndetësore për kalimin e fondeve financiare dhe kontrollin e tyre.
4. Fondet nga buxheti i shtetit të caktuara e destinuar për shërbimet shëndetësore parësore i kalojnë drejtpërdrejt ISKSH-së.

XV. Dispozita të përgjithshme e tranzitore

1. Drejtoria e Higjenës dhe Epidemiologjisë, Inspektimi Sanitar, si dhe Zyrat e Shëndetit Publik për Tiranën dhe Rrethin e saj, shkrihen dhe funksionet e tyre i kalojnë ASHR-së.
2. Punonjësit dhe stafet e tyre respektive punësohen me kontrata të rregullta nga ASHR-ja.
3. Seleksionimi i stafit ekzistues dhe transferimi i tij tek ASHR-ja do të bëhet në bashkëpunim nga menaxherët e MSH dhe ASHR-së.

XVI. Afatet

1. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe ISKSH që brenda 4 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi të marrin të gjitha masat me qëllim që ASHR të fillojë funksionimin e plotë në përmbushje të kompetencave që njihen me këtë vendim.
2. Për përllogaritjet e efekteve financiare që do të ketë krijimi i këtij i institucioni, ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Minsitria e Financave.

V E N D I M
Nr.396, datë 27.7.2000

**PËR NJOHJEN E PERIUdhËS SË SIGURIMIT PËR EFEKT PENSIONI DHE AKSIDENTI
NË PUNË TË TË DËNUARVE ME BURGIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtutës, të nenit 35, të ligjit nr.8328, datë 16.4.1998 dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Për efekt të njohjes së periudhës së sigurimit për pension dhe aksident në punë, në pagën që u jepet personave të cilët punojnë gjatë kohës që janë të dënuar me burgim, do të llogaritet kontributi për sigurimet shoqërore në mbështetje të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", dhe të shtesave dhe ndryshimeve që i janë bërë këtij ligji.

2. Paga, për të cilën i dënuari do të sigurohet, nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale e vitit përkatës, e cila caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Organet e administratës së repartit ku i dënuari kryen dënimin me burg do të llogarisin masën e kontributit nga paga që i jepet të dënuarit kur ai punon.

4. Kontributi për sigurime shoqërore, në bazë të pagës mujore që i takon të marrë i dënuari me burgim, do të llogaritet në masën 31.7 për qind për pension dhe 5 për qind për aksident pune. Pagesa e këtij kontributi do të realizohet duke zbritur 10 për qind nga paga bruto që merr i dënuari, ndërsa pjesa tjetër do të paguhet nga punëdhënësi në masën 21.7 për qind dhe 0.58 për qind të shumës bruto të listëpagesës.

5. Kontributi do të derdhet në emër të të dënuarit, në llogarinë e sigurimeve shoqërore të atij rrethi nën juridiksionin e të cilit ndohet repartit ku i dënuari kryen dënimin. Masa e pagesës dhe ndalesa e kontributit për pension pleqërie të pasqyrohen në listëpagesat-tip, të miratuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, të cilat, nëpërmjet bankës, depozitohen pranë organeve të sigurimeve shoqërore së bashku me urdhërshkrimin.

6. Ky vendim i shtrin efektet financiare duke filluar nga dat 1.1.1999.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.398, datë 27.7.2000

**PËR PËRJASHTIM TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE NGA PAGESAT E
PRAPAMBETURA TË QIRASË SË TOKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtutës dhe në zbatim të nenit 7, të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jo bankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", dhe neni 6, pika 1 e ligjit nr.8360 me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Qiratë e papaguara të tokës që shoqëritë huamarrëse, për asete në pronësi sipas lidhjes bashkëlidhur, kanë me kontrata, me këshillat e komunave apo bashkive, nuk janë pjesë e skemës së shpërndarjes së vlerave financiare, dhe si të tilla nuk shlyhen nga administratorët.

2. Me shitjen e aseteve në pronësi të shoqërive huamarrëse, dhe transkriptimin e pronësisë, qiraja e tokës paguhet nga blerësit e rinj.

Llogaritja e qirasë së tokës fillon me lidhjen e kontratës me këshillin e komunës apo të bashkisë dhe vazhdon deri në privatizimin e saj.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Lokal, Grupi Mbikëqyrës dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

SIPËRFAQET E TROJEVE TË OBJEKTEVE NË PRONËSI TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE,
PËR TË CILAT NUK PAGUHET QERAJA E PRAPAMBETUR

Nr.	Objektet	Shoqëria në administrim	Sip. e tokës me qira m2
1.	Pularia Yzberisht	“Vefa Holding”	16 000
2.	Kompleksi i Derrit Paskuqan	“Vefa Holding”	44 480
3.	Kombinati i therrjes së Shpendëve në	“Vefa Holding”	5 086
4.	Kompleksi i Shpendëve Paskuqan	“Vefa Holding”	36 200
5.	Kompleksi i Pularisë së Vezëve Fier	“Vefa Holding”	36 700
6.	Kompleksi i Gjelit të Detit Lushnje	“Vefa Holding”	28 000
7.	Frigorifer Lushnje	“Vefa Holding”	10 200
8.	Pularia Shushicë Elbasan	“Vefa Holding”	69 700
9.	Fabrika e Vajit Himarë	“Vefa Holding”	14 400
10.	Fabrika e Llokumeve Fier	“Vefa Holding”	3 990
11.	Ndërtesa në Bukonik Elbasan	“Vefa Holding”	1 340
12.	Ndërtesa në Gjinan Elbasan	“Vefa Holding”	2 000
13.	Kabina dhe Bar-Bufe në Plazhin e Vlorës	“Vefa Holding”	1 499
14.	Parku i Industrisë Vlorë	“Vefa Holding”	7 580
15.	Magazinë Konservash Vlorë	“Vefa Holding”	825
16.	Fabrika e Birrës Vlorë	“Cenaj&Co”	12 000
17.	Kompleksi i rritjes së derrit Akerni Vlorë	“Kamberi”	68 800
18.	Nyje e betonit	“Kamberi”	11 360
19.	Plazhi Kristal dhe i Palasës	“Kamberi”	5 500
		Shuma	375 660

VENDIM
Nr.400, datë 27.7.2000

**PËR MIRATIMIN E PRIVATIZIMIT TË NDËRMARRJES SË PRODHIMIT TË
ÇIMENTOS, FUSHË-KRUJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 23, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të nenit 4, shkronja “ç”, të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, të vendimit nr.408, datë 31.8.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin me tender të ndërmarrjeve shtetërore” dhe të vendimit nr.433, datë 9.9.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin me tender të ndërmarrjes së prodhimit të çimentos, Fushë-Krujë“, me ndryshime përkatëse, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e privatizimit të ndërmarrjes së prodhimit të çimentos, Fushë-Krujë, dhe shpalljen fitues të saj të “R.M.C Group p.o.c.&E.C.F.SH.A. “Konsorcium”, si ofertë e vetme.
2. Objekt i kontratës së shitjes së ndërmarrjes së prodhimit të çimentos, Fushë-Krujë, të jetë edhe shitja e sipërfaqes së truallit të saj.
3. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.405, datë 27.7.2000

PËR KUSHTET E NXJERRJES SË PULLËS POSTARE SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr.8530, datë 23.9.1999, “Për Shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë“, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pulla postare shqiptare, me cilësinë e letrës me vlerë, shërben për pagesën e shërbimeve që kryejnë zyrat e “Albapost”, sh.a., për pranimin, transportimin dhe shpërndarjen e letërkëmbimit postar.
2. Pranë DPPT-së funksionon komisioni shtetëror i pullës postare shqiptare. Kryetari i këtij komisioni është drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Postave dhe Telekomunikacioneve dhe në përbërje ka personalitete të njohura të shkencës, kulturës, artit, përfaqësues të shoqatave të filatelistëve, si dhe përfaqësues nga “Albapost” sh.a.
Anëtarët e këtij komisioni emërohen nga ministri.
3. Përcaktimi i tematikave vjetore bëhet nga komisioni shtetëror i pullës postare shqiptare. Si rregull, tematika caktohet brenda tremujorit të parë të vitit paraardhës, duke u mbështetur në propozimet e sjella nga ministrinë, institucionet e tjera shkencore, artistike si dhe shoqatat e ndryshme, lidhur me natyrën e fushës së veprimtarive të tyre, bazuar kjo në kërkesën e DPPT-së.

4. Emetimi, vënia dhe heqja nga qarkullimi i çdo emisioni të pullave postare shqiptare, miratohet nga drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Postave dhe Telekomunikacioneve.

5. Çmimi i shitjes së pullave postare shqiptare për nevojat e shërbimit postar nuk mund të jetë më i vogël se vlera nominale e shënuar në pullë. Çmimi dhe tirazhi i çdo emisioni miratohet nga ministri me propozimin e “Albapost” sh.a., në përputhje me tarifat e miratuara dhe nevojat e shërbimit postar, si dhe kërkesat e shërbimit filatelik.

6. Për veprimtarinë që kryejnë, anëtarët e komisionit shtetëror të pullës postare shqiptare marrin një shpërblim vjetor, masa e të cilit caktohet me udhëzim të veçantë të ministrit, dhe përballohet nga “Albapost” sh.a.

7. Pullat postare shqiptare shtypen në ente të specializuara, të zgjedhura në mbështetje të dispozitave në fushën e prokurimeve. Në çdo rast, konkurrentët duhet të jenë të pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për shtypjen e letrave me vlerë.

Shtypja, marrja në dorëzim, administrimi, shpërndarja dhe shitja e pullave postale shqiptare bëhet nga “Albapost” sh.a., në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të cilat rregullojnë shërbimet e letrave me vlerë.

8. Për përgatitjen e skicave dhe të boceteve të emisioneve të pullave postare shqiptare, të përcaktuara në tematikën vjetore, organizohet konkurs. Kriteret e shpalljes së konkursit dhe dhënia e çmimeve përcaktohen sipas vendimit nr.595, datë 29.12.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e shpalljes së konkurseve me karakter kombëtar e lokal dhe dhënien e çmimeve për to”.

Të gjitha punimet e paraqitura në konkurs ruhen në “Muzeum e pullës postare shqiptare”.

Shpërblimi i autorëve të shpallur fitues, bëhet nga “Albapost” sh.a. masa e shpërblimit për fituesit, nga i pari tek i treti, caktohet nga këshilli mbikëqyrës i “Albapost” sh.a.

9. “Albapost” sh.a., organizon shitjen e pullave për nevojat e shërbimit nëpërmjet zyrave të postës, si dhe subjekteve të tjera, në bazë të kontratgës të lidhur me to.

10. Shitja e pullave postare shqiptare për qëllime filatelike, brenda dhe jashtë vendit, bëhet nga “Albapost” sh.a., nëpërmjet shoqërive dhe agjencive tregtare vendase ose të huaja. Për shitjen në sasi të mëdha, në tregun filatelik, “Albapost” sh.a., zbaton zbritje kundrejt çmimit nominal, i vijon:

a) për seri të plota, të pavulosura deri në masën 20 për qind.

b) për seri të shkurtuara, të vulosura deri në masën 80 për qind.

c) për emisionet e mbetura stok, të emetuara deri në vitin 1993, vlera nominale e të cilave është shprehur në qindarka dhe në lekë, deri në masën 30 për qind kundrejt vlerës së konvertuar në dollarë amerikanë, sipas kursit të këmbimit të periudhës përkatëse të emetimit të serisë, me të cilën është përcaktuar çmimi i shitjes në dollarë amerikanë.

Sasitë e shitjes së pullave postare shqiptare, për të cilat zbatohen zbritjet në përputhje me gerrat e mësipërme “a”, “b”, “c”, përcaktohen me udhëzim të veçantë të ministrit.

11. Për emisionet e mbetura stok, që kanë humbur mundësinë e përdorimit për afrankim, si dhe që, për shkak të qëndrimit të gjatë kanë humbur parametrat cilësore filatelie, “Albapost” sh.a., ka të drejtën e asgjësimit të tyre, duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.

12. “Albapost” sh.a., bën publikimin e pullave postare shqiptare, nëpërmjet materialeve informative, rreklamimit, simpoziumeve dhe pjesëmarrjes në ekspozita e panairë kombëtare e ndërkombëtare.

13. “Muzeu i pullës postare shqiptare”, administrohet nga “Albapost” sh.a., në përputhje me legjislacionin në fuqi për ruajtjen e vlerave muzeale.

14. Ngarkohet ministri, të nxjerrë udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

15. Vendimi nr.497, datë 13.8.1998 i Këshillit të Ministrave, “Për pullën postare shqiptare”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.407, datë 27.7.2000

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË RISTRUKTURIMIT TË BANKËS SË
KURSIMEVE, SH.A.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenve 6, 12, dhe 14, të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998, “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” dhe të neneve 6 dhe 7, të ligjit nr.8563, datë 22.12.1999, “Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të Bankës së Kursimeve, sh.a.,” me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e programit dhe të strategjisë së ristrukturimit të Bankës së Kursimeve, sh.a., të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi, përpara fillimit të procedurave të privatizimit.
 2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.409, datë 27.7.2000

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.157, DATË 26.2.1998, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR FILLIMIN E PUNËS SË ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME NË DISA RRETHE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 dhe 57, të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të neneve 21 dhe 27, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 7, të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000”, me propozimin e ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në pikën 2, të vendimit nr.157, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, hiqen fjalët “Malësi e Madhe”, dhe “Shkodër” dhe shtohen paragrafët si më poshtë:

“2.2. Në rrethin e Malësisë së Madhe, me qendër në Koplik, nga data 1 korrik 2000 hapet dhe fillon punën zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

2.3. Kryeregjistruesi i pasurive të paluajtshme të marrë masa për lëvizjen, sistemimin dhe sigurimin e dokumentacionit nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në Shkodër.

2.4. Për hapjen e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme në Malësinë e Madhe, këshilli i rrethit të marrë masa për sigurimin e jo më pak se 200 m² sipërfaqe, për mjediset e kësaj zyre.

2.5. Në strukturën organike të sistemit të regjistrimit, për zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në Malësinë e Madhe, shtohen 5 veta. Shpenzimet për pagat, sigurimet shoqërore, prej 1.3 milionë lekësh, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

2.6. Ngarkohen kryeregjistruesi i pasurive të paluajtshme, prfektura dhe këshilli i rrethit të

Malësisë së Madhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

UDHËZIM MBI PROCEDURAT E RISHIKIMIT TË LISTAVE PARAPRAKE TË ZGJEDHËSVE

1. Përgjegjësia, vendi dhe personat që do të merren me rishikimin e listave paraprake të zgjedhësve

- KZQV-të përgjegjëse për rishikimin e listave
- KZQV-të janë përgjegjëse për procesin e rishikimit të listave paraprake të zgjedhësve.
- Rishikimi i listave paraprake të zgjedhësve do të bëhet nën drejtimin e KZQV-ve në bashkëpunim me komisionet e regjistrimit të votuesve të bashkive dhe komunave.

a. Vendi i rishikimit të listave paraprake të zgjedhësve

- Rishikimi i listave paraprake dhe shpërdarja e kartave të zgjedhësve do të bëhen në të njëjtin ambjent pune në "Qendrat e Shpërdarjes së Kartave dhe të Rishikimit të Listave Paraprake" (QSHK dhe RLP) të cilat do të jenë 500 në të gjithë teritorin e Shqipërisë (nga një për bashkitë dhe komunat e vogla dhe më shumë se një në bashkitë dhe komunat e mëdha.
- Rekomandohet që kjo qendër të jetë pranë një shkolle ose në një ambjent tjetër të miratuar nga KZQV-ja e njësisë zgjedhore përkatëse.

b. Kush do të merret me rishikimin e listave paraprake

- KZQV-të janë përgjegjëse për procesin teknik të rishikimit dhe miratojnë çdo rishikim që do të bëhet në listat paraprake të zgjedhësve.
- Në bashkitë dhe komunat e vogla procesi teknik i rishikimit të listave paraprake të zgjedhësve do të bëhet nga antarët e KZQV-ve
- Në bashkitë dhe komunat e mëdha KZQV-të do të autorizojnë grupe rishikimi që do të merren me procesin teknik të rishikimit të listave paraprake të zgjedhësve, pas nënshkrimit të një teksti betimi. Grupet e rishikimit do të përbëhen nga tre persona të rekomanduar një nga pozita, një nga opozita dhe një punonjës i administratës së pushtetit vendor.
- Në çdo QSHK dhe RLP në dispozicion të KZQV-ve dhe grupeve të rishikimit të listave paraprake do të jetë një grup prej tre vetësh që do të bëjnë verifikimin derë më derë të kërkesave që do të paraqiten për rishikimin e listave paraprake nga zgjedhës të veçantë ose parti politike. Ato do të përbëhen nga një përfaqësues i opozitës, një i pozitës dhe një punonjës i administratës së pushtetit vendor.

2. Listat paraprake të zgjedhësve

- Listat paraprake të zgjedhësve do të përgatiten në 3 kopje. Njëra prej tyre do të përdoret për shpalljen e emrave dhe të dhënave të tjera të zgjedhësve në çdo qendër votimi, tjetra për shpërndarjen e kartave kurse e treta do të përdoret për procesin e rishikimit.
- Të tre kopjet e listave do të përmbajnë të njëjtin informacion në të njëjtën formë paraqitjeje: numrin rendor, numrin e kartës së zgjedhësit, emrin, atësinë, mbiemrin e zgjedhësit, emrin e komunës ose bashkisë, numrin e qendrës së votimit të zgjedhësit që përfshihet në atë listë, si dhe dy kollona bosh që do të përdoren njëra për vendosjen e firmës së zgjedhësit dhe

personave që do të merren me shpërdarjen dhe rishikimin dhe tjetra për shënime.

a. Shpallja e listave paraprake të zgjedhësve

- KZQV-të shpallin në një vend të dukshëm në çdo qendër votimi të njësisë së tyre zgjedhore listat paraprake të zgjedhësve.
- KZQV-të do të afishojë pranë listave paraprake të zgjedhësve edhe adresën e QSHK dhe RLP ku zgjedhësit e asaj qendre votimi do të drejtohen për marrjen e kartave të zgjedhësit dhe rishikimin e listave paraprake në rastet kur ka pasaktësi në listat.

b. Njoftimi në mediat e shkruara dhe ato elektronike për shpalljen e listave paraprake të zgjedhësve dhe vendndodhjen e QSHK dhe RLP

- Para dhe pas shpalljes së listave paraprake të zgjedhësve KQZ-ja si dhe KZQV-të e bashkive dhe komunave, nëpërmjet mediave elektronike dhe atyre të shkruara, si dhe formave të tjera (përshëmbull posterave) njoftojnë zgjedhësit që ata të drejtohen në vendet ku janë shpallur listat paraprake të qendrës së tyre të votimit për të parë (kontrolluar) nëse emri i tyre: është në listë, është shkruar saktë apo me gabime (edhe të dhënat e tjera për të) nuk ndodhet fare në listë. Ato njoftojnë zgjedhësit që të drejtohen në QSHK dhe RLP respektive për të marrë kartën e zgjedhësit, për të bërë ndryshimin e emrit apo të dhënave të tjera të tyre në rast pasaktësie apo shtimin e emrit të tyre në rastet kur ai mungon në këto lista.
- KQZ-ja nëpërmjet mediave dhe formave të tjera njofton që çdo zgjedhës ose parti politike ka të drejtë të kërkojë korigjimin e pasaktësive në listat paraprake të zgjedhësve në përputhje me kushtet e nenit 12 të kodit civil dhe neneve 55 deri 58 të kodit zgjedhor (mediat japin përbajtjen e këtyre neneve)

c. Listat që do të përdoren për shpërndarjen e kartave të zgjedhësve dhe për procesin e rishikimit

- Lista e dytë do të përdoret për shpërndarjen e kartës së zgjedhësit. Shpërndarja e kartës së zgjedhësit do të bëhet sipas udhëzimeve që jepen në Manualin Operacional.
- Lista që do të përdoret për rishikim do të printohen në letër me ngjyrë për ta dalluar atë nga kopjet e tjera.

3. Paisja e zgjedhësve me kartat e zgjedhësve

a. Zgjedhësit që pajisen drejtpërdrejtë me kartën e zgjedhësit

- Zgjedhësit pas shpalljes së listave paraprake të zgjedhësve në qendrat e tyre të votimit drejtohen në QSHK dhe RLP për marrjen e kartës së zgjedhësit.
- Zgjedhësit paraqesin në QSHK dhe RLP kuponin dhe njërin nga dokumentet e më poshtëme të identifikimit:
 - Letër njoftimin
 - Pasaportën për jashtë shtetit
 - Çertifikatë lindjeje me fotografi
- Të gjithë zgjedhësit që kanë kupon si dhe ata që nuk kanë kupon (pasi kanë paraqitur një nga dokumentet e identifikimit të përmendura më sipër) që e kanë emrin në listë dhe nuk kanë ndonjë ankesë për drejtëshkrimin e emrit dhe të dhënave të tjera të tyre paisen me kartën e zgjedhësit sipas procedurave që tregohen në "Manualin Operacional"

b. Zgjedhësit që kalojnë në procesin e rishikimit

- Të gjithë zgjedhësit që nuk janë dakort me drejtëshkrimin e emrit dhe të dhënat e tjera të

tyre ose që nuk e kanë emrin në këto lista drejtohen tek personat(KZQV-ja ose grupet e rishikimit) që merren me rishikimin e listave paraprake të zgjedhësve.

- Kartat e zgjedhësve ku emri apo të dhëna të tjera të tyre janë shkruar gabim kalohen tek personat që merren me rishikimin e listave (KZQV-ja) , të cilët më pas i dërgojnë ato në KQZ (FIK).

4. Ndryshimi i listave paraprake të zgjedhësve

a. Kush mund të kërkojë ndryshimin e listave paraprake të zgjedhësve

- Çdo zgjedhës ose parti politike ka të drejtë të kërkojë nga KZQV-ja korrigjimin e pasaktësive në listat paraprake të zgjedhjeve, në përputhje me kushtet e nenit 12 të kodit civil dhe neneve 55 deri 58 të kodit zgjedhor.

b. Shkaqet për ndryshime në listat paraprake të zgjedhësve

- Listat e zgjedhësve ndryshohen kur një zgjedhës :
 - provon se të dhënat e tij vetiake në lista nuk janë të sakta
 - ka ndryshuar vendbanim ose vëndqëndrim
 - vdes
 - ka humbur të drejtën për të zgjedhur
 - është regjistruar në më shumë se një listë

c. Deri kur mund të bëhen ndryshime në listat paraprake të zgjedhjeve

- KZQV-ja nuk mund të bëjë ndryshime në listat paraprake të zgjedhësve gjatë 17 ditëve të fundit para datës së zgjedhjeve.

d. Procedurat e ndryshimit të listës paraprake të zgjedhësve

Procedurat e ndryshimit të listave paraprake të zgjedhësve kur një zgjedhës:

(a) Provon se të dhënat e tij vetiake në lista nuk janë të sakta:

- Në qoftë se zgjedhësi me anën e dokumentave të tij të identitetit (dokumenta që u përmendën më lart) provon që të dhënat e tij në listën paraprake të zgjedhësve nuk janë të sakta (përshembull emri, mbiemri, atësia apo datëlindja e tij janë shkruar në mënyrë të gabuar) atëherë personat që merren me rishikimin e listave (KZQV-ja dhe grupet e autorizuara prej tyre) i heqin një vijë emrit të pasaktë të zgjedhësit në listë dhe në fund të listës në formularin bosh me ngjyrë shkruajnë me kujdes të dhënat e sakta të zgjedhësit.

- Për të dy veprimet e kryera në kollonën për firmat firmosin si zgjedhësi ashtu edhe rishikuesit e listave.

- Në kollonën e shënimeve shkruhet numri i zgjedhësit të cilit i është hequr vijë si dhe arsyeja e heqjes së emrit në listë.

- Zgjedhësit i jepet një nga dy kopjet e faturës ku tregohet që ai është shtuar në listën e zgjedhësve(kopja e dytë mbahet nga KZQV-ja).

- Zgjedhësit i thuhet që ai do ta marrë kartën e zgjedhësit në të njëjtën zyrë në një ditë të mëvonshme, pas përfundimit të afatit të rishikimit të listave paraprake.

- Karta e tij, që përmban të dhëna të pasakta, dërgohet në KQZ (FIK), nga KZQV-ja.

(b) Ka ndryshuar vendbanim ose vëndqëndrim:

(emri i tij nuk ndodhet në listën paraprake të afishuar të zgjedhësve)

- Në qoftëse një zgjedhës kërkon të shtohet në listën e zgjedhësve emri i tij për shkak se ka

ndryshuar vendbanim ose vendqëndrim ai duhet të tregojë një dokument që provon këtë ndryshim ose duhet të tregojë adresën e re të vendbanimit apo vendqëndrimit të ri të tij si dhe adresën e vendqëndrimit të tij të mëparshëm.

- Në qoftë se një parti politike (ose koalicion) kërkon të shtohet në listë emri i një zgjedhësi që ka ndryshuar vendbanim ose vendqëndrim ajo duhet të tregojë adresën e re të vendbanimit apo vendqëndrimit të tij si dhe adresën e vendqëndrimit të tij të mëparshëm.

- Mbi bazën e këtyre të dhënave (të dhëna nga zgjedhësi apo partia politike) dërgohet grupi tresh i cili bën verifikimin e adresës së re të zgjedhësit.

- Pasi bëhet verifikimi të dhënat e zgjedhësit shtohen me dorë në fund të listës në formularin bosh me ngjyrë (në formular shënohet edhe adresa e tij e mëparshme).

- Për veprimin e kryer në kolumnën për firmat firmosin si zgjedhësi ashtu edhe personat e rishikimit të listave.

- Zgjedhësit i jepet një nga dy kopjet e faturës ku tregohet që ai është shtuar në listë (kopja e dytë mbahet nga KZQV-ja).

- Zgjedhësit i thuhet që ai do ta marrë kartën e zgjedhësit në të njëjtën zyrë në një ditë të mëvonshme, pas përfundimit të afatit të rishikimit të listave paraprake.

(c) Vdes ose ka humbur të drejtën për të zgjedhur:

- Në këtë rast pasi merret informacioni, se një person që ndodhet në listën e zgjedhësve ka vdekur ose ka humbur të drejtën për të zgjedhur (prej familjes, të afërmeve të tij, individëve të tjerë apo partive politike) dërgohet grupi tresh i verifikimit në zyrat e gjëndjes civile për të marë certifikatën e vdekjes si dhe verifikohet që personi ka humbur të drejtën për të zgjedhur.

- Mbi bazën e dokumentacionit të siguruar nga grupi i verifikimit i hiqet një vijë këtyre emrave në listën e zgjedhësve dhe rishikuesit e listave firmosin në kolumnën e firmave përkrah këtyre emrave.

- Në kolumnën e shënimeve tregohet numri i zgjedhësit të cilit i është hequr vijë si dhe arsyeja pse është hequr emri i zgjedhësit nga lista.

(d) Është regjistruar në më shumë se një listë:

- Në këtë rast personat që merren me rishikimin e listave paraprake në QSHK dhe NLP pasi njihen me ankesën (që mund të bëhet nga vetë zgjedhësi, apo një parti politike) mbi bazën e informacionit të marrë prej tyre dërgojnë grupin tresh për të verifikuar nëse personi është apo nuk është me banim të përhershëm apo të përkohshëm në territorin që mbulohet nga qendra përkatëse e votimit. Informacioni i marrë nga grupi i verifikimit regjistrohet dhe dërgohet nga KZQV-ja në KQZ(QIF).

- Në të gjitha rastet e përmendura më sipër rishikimet që do të bëhen listave paraprake të zgjedhësve do të miratohen në KZQV-në përkatëse dhe më pas këto ndryshime do të dërgohen në KQZ (QIF)

5. Kompjuterizimi dhe printimi i listave përfundimtare të zgjedhësve

a. Dërgimi nga KZQV-të në KQZ (QIF) i dokumentacionit që do të shërbejë për ndryshimin e listave paraprake të zgjedhësve.

- Gjatë periudhës së rishikimit të listave paraprake çdo dy ose tre ditë, pas miratimit të rishikimeve KZQV-ja do të dërgojë në KQZ (QIF) formularët shtesë me ngjyrë (kopjen e dytë të tij) në të cilët ndodhet informacioni për ndryshimet që duhet t'i bëhen listave paraprake.

- Kur periudha e rishikimit të listave paraprake të zgjedhësve përfundon KZQV-të brenda 24 orëve dërgojnë në KQZ (QIF) listën paraprake të zgjedhësve me ngjyrë ku janë bërë ndryshimet si dhe kopjen e parë të formularëve me emrat shtesë të zgjedhësve firmosur nga antarët e KZQV-së.

- KQZ-ja miraton ndryshimet në listat paraprake

b. Kompjuterizimi i listave përfundimtare të zgjedhësve dhe dërgimi i tyre në KZQV-të

- QIF kompjuerizon ndryshimet e miratuara nga KQZ në listat paraprake dhe printon listën përfundimtare të zgjedhësve.

- KQZ-ja i dërgon KZQV-ve listën përfundimtare të zgjedhësve 7 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

6. Printimi dhe shpërndarja e kartave shtesë

a. Printimi i kartave shtesë në "Qendrën e informatizimit financiar"

- QIF printon kartat shtesë për zgjedhësit emrat e të cilëve gjatë procesit të rishikimit janë ndryshuar ose janë shtuar.

b. Shpërndarja e kartave shtesë zgjedhësve

- KQZ ju dërgon QSHKZ kartat shtesë të zgjedhësve. Këto të fundit i shpërndajnë ato deri një ditë para datës së zgjedhësve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

V E N D I M NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Thimjo Kondi	Kryetar
Agron Lamaj	Anëtar
Artan Hoxha	"
Bashkim Caka	"
Metush Saraçi	"
Natasha Sheshi	"
Vangjel Kosta	"
Petrit Piloçi	"
Nikoleta Kita	"
Valentina Kondili	"
Vladimir Bineri	"
Vladimir Metani	"

në seancën gjyqësore të datës 22.06.2000 mori në shqyrtim çështjen civile Nr.1800 që i përket:

PADITËS: Spiro Kristo i përfaqësuar nga avokati Viktor Konomi

I PADITUR: Anastas Reçka i përfaqësuar nga avokati Anastas Duro

OBJEKTI I PADISË: Deklarimi i pavlefshëm i kontratës së huasë ne Nr.Rep.1757 Kol.599 datë 14.10.1996, në bazë të neneve 92 e 686 të Kodit Civil dhe nenit 153 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e rrethit gjyqësor Sarandë, me vendimin nr.224, datë 22.04.1998, ka rrëzuar padinë e ngritur nga paditësi Spiro Kristo kundër të paditurit Anastas Reçka.

Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr.5, datë 09.06.1998, ka ndryshuar vendimin e mësipërm dhe e ka shpallur të pavlefshme kontratën e huasë Nr.1757, datë 14.10.1996, duke lejuar palët të respektojnë kontratën e lidhur midis tyre dhe firmës “Kamberi”.

Mbi rekursin e bërë nga i padituri Anastas Reçka, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.674, datë 16.04.1999, ka prishur vendimin e gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor Sarandë.

Kundër vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor Sarandë dhe kundër vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë kanë bërë rekurs paditësi Spiro Kristo dhe pala e tretë në gjykim Marika Kristo, duke parashtruar këto shkaqe:

Në gjykimin në Gjykatën e Lartë nuk është respektuar ligji material, nenet 92-111 dhe 681-689 të K.C, por është konkluduar vetëm duke u referuar në ligjën procedurale, duke keqpërdorur nenin ndalues 232 të K.Pr.Civile. Objekt gjykimi nuk ka qenë qenia ose jo e aktit dhe vërtetësia e tij, por pavlefshmëria e aktit juridik.

Nga aktet e ndodhura në dosje rezultojnë se të dyja palët ndërgjyqëse janë kreditorë të evidentuar tek firma “Kamberi”, për shumën e peretenduar. Gjykata nuk ka marrë një provë të kërkuar nga paditësi e cila më vonë është garantuar prej tij, shkresa e datës 26.05.1999, gjë që vjen në kundërshtim me nenin 472/c të K.Pr.C.

Pala e tretë Marika Kristo bashkëpronare e magazinës të vënë në garanci, nuk rezultojnë debitore ndaj të paditurit sipas kontratës së lidhur me paditësin.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjuan relacionet e gjyqtarëve Artan Hoxha dhe Agron Lamaj, prokurorin Bujar Sheshi i cili kërkoi, lënien në fuqi të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, avokatin Viktor Konomi i cili kërkoi prishjen e vendimit të Kolegjit civil të Gjykatës së Lartë dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së Apelit, avokatin Anastas Duro i cili kërkoi, lënien në fuqi të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe pasi e biseduan çështjen në tërësi konkludojnë se është rasti të unifikohet praktika gjyqësore lidhur me:

1. Veprimi juridik kur mund të konsiderohet i simuluar dhe cilët janë elementet thelbësorë që e bëjnë atë të tillë.

2. Si duhet kuptuar parashikimi i bërë në nenin 686/2 të Kodit Civil lidhur me humbjen apo dëmtimin e shpërpjestuar të interesave të palëve në një kontratë.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë pasi shqyrtuan aktet e çështjes.

V Ë R E J N Ë:

Vendimi nr.674 datë 16.04.1999 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nuk është i mbështetur në ligj e për këtë shkak duhet të ndryshohet.

Nga gjykimi i çështjes në shkallë të parë dhe në apel ka rezultuar e provuar se paditësi Spiro Kristo me të paditurin Anastas Reçka me datën 14.10.1996 kanë lidhur një kontratë huaje sipas së cilës paditësi i ka marrë të paditurit hua shumën prej 12 500 000 dhrahmi për një vit. Në përfundim të këtij afati paditësi detyrohet të kthejë shumën e mësipërme si dhe interesat për të, gjithsej shumën 22 500 000 dhrahmi. Si garanci për përmbushjen e detyrimit të mësipërm është vënë një magazinë për të cilën gjatë gjykimit është pretenduar se është në bashkëpronësi të paditësit me bashkëshorten e tij.

Po më datën 14.10.1996 është lidhur një kontratë me firmën “Kamberi” për të njëjtën shumë, ku si palë huadhënëse ka nënshkruar vetëm paditësi Spiro Kristo, por duke përfshirë në të si kreditor edhe të paditurin Anastas Reçka.

Paditësi Spiro Kristo ka paraqitur për gjykim në gjykatën e rrethit gjyqësor Sarandë paditën me objekt pavlefshmërinë e kontratës së huasë të datës 14.10.1996 të lidhur midis tij dhe të paditurit Anastas Reçka.

Gjykata e rrethit Sarandë me vendimin nr.224, datë 22.04.1998 e ka rrëzuar kërkesë padinë e ngritur prej tij me arsyetimin se kontrata e lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse është një kontratë e përfunduar në përputhje me të gjitha dispozitat e parashikuara në ligj, është nënshkruar prej palëve me vullnet të lirë dhe si e tillë ajo është e vlefshme dhe duhet të realizojë të gjitha efektet e saj.

Mbi ankimin e paditësit, Gjykata e Apelit Gjirokastër me vendimin nr.53, datë 09.06.1998, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë Sarandë duke e shpallur të pavlefshme kontratën e lidhur midis palëve ndërgjyqëse dhe, siç thuhet në vendim, ka lejuar palët të respektojnë kontratën e huasë të lidhur midis tyre dhe firmës “Kamberi”, me arsyetimin se kushtet e kontratës sjellin dëmtim të shpërpjestuar të interesave të paditësit dhe se magazina e vënë si garanci për përmbushjen e detyrimit duke qenë në bashkëpronësi e bën garancinë të pavlefshme. Ajo ka pranuar gjithashtu se kontrata e datës 14.10.1996 e lidhur midis palëve është një veprim juridik për të mbuluar një tjetër veprim juridik e konkretisht atë të kontratës së huasë të lidhur me firmën “Kamberi”, gjë që vërtetohet edhe me mandat arkëtimin nr.1766, datë 14.10.1996, me atë të të cilit është depozituar shuma e mësipërme.

Mbi ankimin e të paditurit Anastas Reçka, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.674, datë 16.04.1999, ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit dhe ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së rrethit gjyqësor Sarandë me arsyetimin se në bazë të nenit 232 të K.Pr.C, nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër, ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar, ose privat që përbën provë të plotë. Kontrata e huasë lidhur midis palëve mund të goditet vetëm për falsitet, ndërsa ajo e lidhur me firmën “Kamberi”, nuk ka fuqi provuese pasi nuk është nënshkruar nga i padituri Anastas Reçka.

Kolegjet e Bashkuara, nga sa është pranuar në bazë të vlerësimit të provave nga gjykatat e dy shkallëve në shqyrtimin gjyqësor, arrijnë në konkluzionin se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nuk është i bazuar në ligj në pjesën arsyetuese të tij dhe pjesërisht edhe në dispozitiv e për këtë shkak duhet të ndryshohet. Kolegji Civil, ka gabuar kur i është referuar vetëm dispozitave të K.Pr.Civile, pasi paditësi nuk ka pretenduar qënien ose jo të veprimit juridik të kontratës së huasë, apo deklarin e pavërtetë të vetë përmbajtjes së saj. Përkundrazi, është pranuar, se kjo kontratë jo vetëm që ekziston objektivisht, por edhe është nënshkruar me vullnet të lirë prej tyre përpara noterit. Ajo që kërkohet në gjykim është pavlefshmëria e veprimit juridik për shkak se qëllimi i vërtetë i tij, nuk ka qenë që paditësi të merrte përsipër kthimin e një huaje me një kamatë shumë të lartë. Gjykata duke mos e marrë në konsideratë faktin e mësipërm dhe duke mos iu referuar ligjit material u ka mohuar palëve të drejtën që sipas rasteve të parashikuara në nenin 92 e vijues të Kodit Civil, të kërkojnë që veprimi juridik të konsiderohet i pavlefshëm.

Po t'i referohemi kontratës së lidhur midis palëve, rezulton se jemi përpara një kontrate huaje të lidhur në përputhje të plotë me kërkesat e K.C., për kontratën e huasë, e konkretisht nenet 1050 dhe 1051 të tij. Duke u nisur jo vetëm nga forma me të cilën është veshur, por edhe në substancë, ky veprim juridik në analizë të përgjithshme i plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për të qenë i vlefshëm.

Nëpërmjet padisë së ngritur prej tij, paditësi Spiro Kristo ka pretenduar se kontrata e huasë me kamatë, e lidhur midis të paditurit Anastas Reçka si huadhënës dhe atij vetë si huamarrës, është një veprim juridik absolutisht i pavlefshëm sepse është i simuluar d.m.th. ekziston një mospërputhje midis vullnetit të vërtetë të palëve dhe shfaqjes së tij të jashtme të materializuar në formën e kontratës së huasë me kamatë të lidhur para noterit. Sipas paditësit vullneti i ndërsjelltë i palëve ka qenë depozitimi i shumës përkatëse në firmën rentiere “Kamberi”, me ndërmjetësinë e paditësit, me qëllim që pas një viti i padituri të përfitonte, krahas shumës së depozituar, edhe një kamatë të barabartë me atë të kontratës së simuluar të huasë të lidhur midis tyre, ndërsa paditësi të përfitonte shpërblimin përkatës, që, do të ishte diferenca midis kamatës që do të jepte firma rentiere “Kamberi” dhe asaj të fiksuar në kontratën e simuluar.

Pretendimet e mësipërme të paditësit rezultojnë të pambështetura në prova e në ligj. Është provuar se ndërmjet palëve është lidhur kontrata e huasë me kamatë në formë noteriale. I ka takuar paditësit barra e provës për të provuar, nga njëra anë, simulimin me atë të kësaj kontrate d.m.th. mungesën e vullnetit të ndërsjelltë dhe të qëllimit të palëve për të ardhur pasojat juridike të shprehura në të, dhe, nga ana tjetër, ekzistencën e vullnetit të ndërsjelltë të vërtetë të paditësit dhe të

paditurit për të lidhur kontratën e depozitimit të parave të paditurit në firmën rentiere “Kamberi”. I padituri Anastas Reçka ka mohuar jo vetëm ekzistencën e vullnetit dhe qëllimit të tij për t’i depozituar paratë e veta tek firma rentiere “Kamberi” nëpërmjet paditësit, por edhe faktin që ai të ketë pasur dijeni në atë kohë, apo më vonë, për këtë veprim të kryer nga paditësi. Palët nuk kanë deklaruar para noterit që shumën e marrë hua me kamatë paditësi e kishte depozituar, apo do ta depozitonte, në kushte të tjera më të favorshme tek firma “Kamberi” dhe kontrata e lidhur me këtë firmë nga paditësi, në interes të të paditurit, si dhe në interes të vet për përqindjen që do të përfitonte si shpërblim, nuk mund të pranohet të paraqitet si provë e paditësit kundër të paditurit, sepse mungon nënshkrimi i këtij të fundit në të.

Në rastin në shqyrtim mungon ai që quhet kundërdeklarim, d.m.th. marrëveshja e veçantë e simulimit, në të cilën shprehet dëshira, vullneti i ndërsjellë i palëve për të lidhur një kontratë të simuluar. Në këtë kundërdeklarim të fshehtë palët shprehen që, në vend të kontratës së simuluar, dëshirojmë një kontratë tjetër të ndryshme. Kontrata e dytë e lidhur midis paditësit dhe firmës rentiere “Kamberi” nuk i ka karakteristikat e marrëveshjes së veçantë të simulimit (kundërdeklarimit).

Gjithashtu, paditësi nuk ka qenë në gjendje të sjellë prova për të provuar sjellje konkrete të të paditurit, para e pas përfundimit të kontratës me firmën “Kamberi”, analiza dhe vlerësimi i të cilave, do të çonte në përfundimin e mungesës së vullnetit e të qëllimit të tij për lidhjen e kontratës së parë (simulimin e saj) dhe të ekzistencës së vullnetit e qëllimit të tij për të përfituar nga kontrata e lidhur prej paditësit me firmën “Kamberi”.

Në rastet e fiktivitetit dhe të simulimit mospërputhjen midis vullnetit dhe shfaqjes së tij e duan vetë palët e veprimit juridik. Veprimi juridik është i simuluar kur kryhet me qëllim që të mbulojë një veprim tjetër juridik të vlefshëm apo të pavlefshëm, të cilin palët kanë dashur ta kryejnë me të vërtetë dhe që rezulton prej kundërdeklarimit si marrëveshje e fshehtë midis tyre.

Në rastin në shqyrtim, nga materialet e çështjes rezulton, se, si veprimi juridik që paditësi e quan “të simuluar”, ashtu edhe veprimi juridik që paditësi e quan “të mbuluar”, nuk janë midis të njëjtave palë dhe janë të dy “të zbuluar”, duke trajtuar secili elementet e tij të veçantë dhe kushtet e nevojshme për ekzistencën e secilit. (Në këtë gjykim nuk përbën objekt shqyrtimi vlefshmëria e kontratës së depozitimit të parave tek skema piramidale “Kamberi”).

Nga atë që rezulton e provuar në këtë çështje, pranohet se qëllimi i paditësit ka qenë që shumën e marrë hua nga i padituri ta depozitonte në firmën rentiere “Kamberi”, duke synuar që, me plotësimin e afatit të kontratës, të mund të shyente detyrimin e marrë përsipër ndaj paditësit, si dhe të realizonte një fitim për vete.

Në rastin në shqyrtim kontrata e paditësit me firmën rentiere “Kamberi” nuk mund të konsiderohet as si kontratë në dobi të një personi të tretë, për shkak se është shënuar në të edhe emri i të paditurit. Në një kontratë të tillë personi i tretë mund të jetë vetëm përfitues pa kundërshpërblim (beneficiar) dhe, si i tillë, ai nuk merr mbi vehte asnjë rrezik eventuale. Janë kontrata në dobi të një personi të tretë disa kontrata të depozitimit të të hollave, por këto para janë të të tjerëve dhe jo të personit të tretë përfitues. Në rast të humbjes së këtyre parave personi i tretë nuk konsiderohet i humbur në kuptimin e pakësimit të pasurisë së vet, por ai nuk arrin të realizojë përfitimin që i është premtuar. Gjithashtu, gjersa nuk pranohet nga i padituri dhe nuk mund të provohet nga paditësi, kontrata me firmën “Kamberi” nuk ka efekte ndaj të paditurit. Një kontratë nuk mund të bëjë debitor apo kreditor pa pëlqimin e tij në person të tretë.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kontratën e paditësit me të paditurin për marrjen hua të shumës prej 12 500 000 dhrahmi e konsiderojnë të ligjshme e të vlefshme. Depozitimi i kësaj shume prej huamarrësit (paditësit) në firmën rentiere “Kamberi” konsiderohet një veprim i njëanshëm i tij, i nisur nga qëllime dhe motive të caktuara, që nuk bazohen në vullnetin e të paditurit (huadhënësit). Në çdo rast, në një kontratë huaje, huadhënësi nuk ka të drejtë të ndërhyjë në mënyrën se si i administron apo i përdor huamarrësi paratë e marra hua. Në këtë kontratë huadhënësi ka të drejtë të kërkojë vetëm kthimin e shumës së dhënë hua, si dhe kamatat e stimuluar, në qoftë se huamarrësi e ka marrë përsipër një detyrim të tillë. Rreziqet eventuale, që rrjedhin nga administrimi i shumës së marrë hua, nga investimi i saj, apo nga kryerja prej huamarrësit me këtë shumë e veprimeve të tjera juridike me qëllim rritjen e fitimeve, rëndojnë

kurdoherë mbi huamarrësin. Në rastin në shqyrtim paditësi është i detyruar t'ia kthejë të paditurit shumën e marrë hua, pavarësisht nga fakti që ai e ka humbur këtë shumë në skemën piramidale. I padituri nuk mund të detyrohet të vuajë konsekuencat e mospërmbushjes së detyrimit që rrjedh nga një veprim juridik ku ai nuk është palë, sikurse është kontrata e lidhur midis paditësit dhe firmës rentiere "Kamberi". Megjithatë, si gjykata e rrethit gjyqësor Sarandë, edhe Kolegji i Civil i Gjykatës së Lartë, kanë gabuar kur kanë pranuar të konsiderohet e vlefshme kontrata e huasë e lidhur midis palëve edhe për pjesën që pranon kamata të tilla që janë jashtë çdo logjike ekonomike. Kolegjet çmojnë se çdo veprimtari bankare apo tregtare e ligjshme, sado e suksesshme që të jetë, nuk mund të krijojë një normë fitimi aq të lartë që të lejojë të paguhet interesat kaq të larta sikurse anë parashikuar në kontratën e lidhur ndërmjet palëve në konflikt. Është e vërtetë se në vitin 1996 në Shqipëri tregu informal i parasë sh[noi norma interesi tep[r t[larta dhe jasht[çdo logjike ekonomike. Por duhet pranuar q[kjo situat[e tregut informal t[paras[i vuri përpara një një konkurrence të ashpër e skllavëruese edhe huamarrësit e vegjël si paditësi, të cilët praktikisht e kishin të vështirë të gjenin para hua me kamata më të ulta se interesat që ofronin skemat piramidale, ndërsa kreditimi prej bankave ishte krejtësisht i asfiksuar.

Është e vërtetë se dispozitat që rregullojnë kontratën e huasë parashikojnë mundësinë e vendosjes së detyrimit për pagimin e kamatave sipas marrëveshjes së palëve dhe se mospagimi i kamatave përbën mospërmbushjen thelbësore të detyrimit (neni 1051 i K.Civil).

Nga ana tjetër Kodi ynë civil nuk ka përcaktuar ndonjë kufi maksimal të kamatave të lejuara, siç parashikojnë legjislacione të vendeve të tjera. Ai ka pranuar parimin e lirisë së plotë të kontraktimit dhe të konkurrencës sipas rregullave të tregut. Ky është qëndrimi më i drejtë për një treg të lirë të mallrave, parave dhe kapitaleve, ku respektohen "rregullat e lojës", por në një treg të deformuar e të pushtuar nga ndërhyrjet e faktorëve të kundërligjshëm deri edhe kriminale, siç ishin skemat mashtruese piramidale, nuk mund të bëhet fjalë për liri të kontraktimit, por për të kundërtën e saj.

Kufiri maksimal i kamatave të lejuara, në legjislacionet përkatëse, shërben si barierë për të shmangur lidhjen e kontratave me kushte të tilla që të çojnë në humbje ose dëmtim të shpërpjesutar të interesave të palës kontraktore. Duke qenë se dispozitat e pjesës së posaçme të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë (...që rregullojnë kontratën e huasë) nuk parashikojnë cakun maksimal të lejuar të kamatave, atëhere bëhet më tepër i domosdoshëm referimi në dispozitat e përgjithshme e parimore lidhur me natyrën ekonomike të detyrimit dhe korrektesës së pjesëmarrësve në të. Sipas nenit 422 të kodit Civil, "Kreditori dhe debitori duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit me korrektesë, me paanësi dhe sipas kërkesave të arsyes". Përmbytja e kësaj dispozite dhe atyre që përcaktojnë kushtet e përgjithshme të kontratave të çon në përfundimin që edhe liria e kontraktimit nuk është absolute. Ajo gjithsesi mund "të kufizohet" nga disa faktorë ekonomikë e moralë, siç janë edhe ato që përmendëm në dispozitën e sipërcituar, e që duhet t'i ketë parasysh edhe gjykata në zgjidhjen e çdo çështjeje konkrete. Injorimi i faktorëve të mësipërm të çon në mungesë proporcionaliteti, apo, siç shprehet ligjvënësi, në dëmtim të shpërpjesutar të interesave të palës kontraktuese, gjë që nënkupton që vullneti (pëlqimi) i kësaj pale nuk ka qenë krejt i lirë.

Sipas nenit 686/2 të Kodit Civil, "janë të pavlefshme kushtet e përgjithshme që sjellin një humbje ose dëmtim të shpërpjestuar të interesave të palës kontraktuese, posaçërisht kur ato ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga parimet e barazisë e të paanësisë të shprehura në dispozitat e këtij kodi që rregullojnë marrëdhëniet kontraktuale".

Në rastin në shqyrtim kontrata e huasë me kamatë është në vetvete një veprim juridik i ligjshëm dhe i vlefshëm. Kusht i përgjithshëm i pavlefshmërisë, sipas nenit 686/2 të Kodit Civil, është pjesa e kamatave që kapërcen limitin e lejuar nga logjika ekonomike, arsyeja e morali, të analizuar më lart. Në raste të tilla gjykatat duhet të kenë parasysh rregullin e njohur sipas të cilit, pjesët e pavlefshme nuk e bëjnë detyrimisht të pavlefshëm të gjithë veprimin juridik. Sipas nenit 111 të K.Civil, "Kur shkak i pavlefshmërisë prej vetëm një pjesë të veprimit juridik, ky mbetet i vlefshëm në pjesët e tjera të tij, përveç kur, sipas përmbytjes së veprimit juridik, këto pjesë paraqesin marrëdhënie të pandashme me pjesën e pavlefshme të veprimit juridik".

Në kundërshtim nga sa pretendon paditësi, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se vënia e magazinës si garanci pasurore e paluatjshme, sikurse janë shprehur palët në kontratë, përforcon dhe

nxjerr në dukje se qëllimi i vërtetë i palëve ka qenë lidhja e kontratës së huasë ndërmjet tyre. Mjeti i përdorur për të siguruar përmbushjen e detyrimit, ka qenë i domosdoshëm pasi shuma e marrë hua është e madhe dhe mundësia e paditësit për ta shlyer brenda afatit kontratën noteriale të huasë me kamatë, pavarësisht nga efektet dhe vlefshmëria e kësaj “garancie pasurore”, të cilat nuk janë objekt shqyrtimi në këtë gjykim, preokupimi i të paditurit (huadhënësit) për të siguruar burime suplementare për të mundësuar garantimin e shlyerjes së detyrimit të marrë përsipër nga paditësi, është një provë e plotë dhe e pakontestueshme e vlefshmërisë së kontratës së huasë.

Pretendimi i paditësit që “garancia pasurore e paluajtshme” është e pavlefshme nuk përbën objekt të këtij gjykimi, por, edhe sikur të pranohej një gjë e tillë, kjo nuk ka asnjë efekt mbi kontratën e siguruar prej saj. Mjetet që sigurojnë ekzekutimin e detyrimeve të parashikuara në Kodin Civil, në vetvete janë kontrata të veçanta subsidiare (plotësuese) të detyrimit kryesor që ato sigurojnë. Si të tilla ato nuk kanë asnjë ndikim mbi detyrimin kryesor dhe pavlefshmëria e tyre, edhe sikur të ekzistojë, nuk ndikon në qënien e në vlefshmërinë e tij. Në rast se garancia është vënë mbi një send për të cilën nuk mund të vihej, apo për një send ku garancia nuk mund të ekzekutohej, kjo e bën vetë këtë të fundit të pavlefshëm dhe detyrimi i marrë përsipër nga veprimi juridik, nuk do të përmbushej me këtë formë ekzekutimi. Kjo nuk do të thotë që detyrimi i lindur nga veprimi juridik, për shkak se nuk ekzekutohej në këtë formë nuk është i vlefshëm, ashtu sikurse ka pranuar gabimisht Gjykata e Apelit, e cila duke e konsideruar garancinë e vënë të pavlefshme, ka shpallur të pavlefshme edhe kontratën e huasë të lidhur midis palëve ndërgjyqësa.

Përfundimisht Kolegjet e Bashkuara arrijnë në konkluzionin që në kuptim të nenit 686/2 të K.Civil, kontrata e huasë e datës 14.10.1996 duhet të konsiderohet e pavlefshme në pjesën e përqindjes së kamatave që duhet të ktheheshin në fund të vitit, pasi sikiurse u pranua edhe më sipër, një aktivitet i ligjshëm nuk mund të realizojë të ardhura për të cilat të paguhen kamata kaq të larta.

Duke u ndodhur përpara këtij fakti, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se veprimi juridik, kontrata e huasë e datës 14.10.1996 e lidhur midis paditësit Spiro Kristo e të paditurit Anastas Reçka, duhet të konsiderohet i vlefshëm me përjashtim të pjesës që bën fjalë për interesat, duke mbetur paditësi debitor tek i padituri për vlerën e huasë së marrë në shumën 12 500 000 dhrahmi dhe të një kamate vjetore, në masën e interesit më të lartë të dhënë nga Banka e Shqipërisë në kohën e lidhjes së kontratës.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 485/d të Kodit të Procedurës Civile, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë,

V E N D O S Ë N:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr.674, datë 16.04.1999 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë me ndryshimin:

Të konsiderojë pjesërisht të pavlefshme kontratën e huasë të datës 14.10.1996 për pjesën e kamatave të pranuar nga palët, që kalojnë përqindjen më të lartë të interesit bankar të aplikuar nga Bankat e Shqipërisë në kohën e lidhjes së kontratës.

2. Një kopje e këtij vendimi unifikues të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 22.6.2000
Nr.1800 Regj.Themeltar
Nr.932 i Vendimit.

U dorëzua për shtyp më 21.8.2000
Doli nga shtypi më 24.8.2000

Tirazhi: 3700 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Tipografia Ushtarake"

Çmimi: 100 lekë